NJOFTIM PËR MEDIA

Në datën 28.10.2025, ora 09:45, në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr."Ismail Qemali", Tiranë, do të hidhet shorti për përcaktimin e trupit gjykues të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, për gjykimin e Kërkesëpadisë Nr.33 Regjistri Themeltar Dt.27.10.2025 Regjistrimi, me:

PADITËS: Gjergj Nika.

I PADITUR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE – KQZ.

OBJEKTI: - Shfuqizimi i vendimit nr.109, datë 26.10.2025 të KAS[1] "PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR.60, DATË 26.10.2025[2], DEPOZITUAR NGA Z.GJERGJ NIKA";

- Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.1437, datë 26.10.2025 duke vendosur: "Regjistrimin e Z.Gjergji Nikë Nika, si kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 nëntor 2025" [3];

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 21, 63, 70, 124, 124/1, e në vazhdim të Kodit Zgjedhor.

Tiranë, më 27.10.2025

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

---

[1] Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), me Vendim Nr.109 Dt.26.10.2025, objekt i kërkesëpadisë, unanimisht, ka vendosur: "*1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.60 të kandidatit për Kryetar Bashkie z.Gjergji Nika, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 nëntor 2025; 2. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit nr.1437, datë 26.10.2025, "Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z.Gjergji Nikë Nika, si kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 nëntor 2025. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor".*

[2] Z.Gjergji Nika, kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 nëntor 2025, ka depozituar në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) Kërkesën Ankimore Nr.60, datë 26.10.2025, me objekt: "*1. Kundërshtimin e vendimit nr.__, datë 26.10.2025 "Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrim të z.Gjergji Nikë Nika, si kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 nëntor 2025; 2. Regjistrimin e z.Gjergji Nikë Nika, si kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 nëntor 2025*".

[3] Komisionieri Shtetëror i Zgjedhjeve, me Vendim Nr.1437 Dt.26.10.2025, objekt i kërkesëpadisë, ka vendosur: "*1. Mosregjistrimin e z.Gjergji Nikë Nika, si kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 nëntor 2025; 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij".*